Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 54
DAT.DT. 28.01.2020
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS
PUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Memorandum i Mirëkuptimit për Punën praktike për të lejuar qasje në Provimin e Jurisprudencës

Memorandumi i Mirëkuptimit për këtë **Program të punës praktike** është lidhur,

me datën 1 shkurt 2020,

ndërmjet

Skender Çoçaj, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, referuar si, "Këshilli Gjyqësor", dhe

Alfons Benjamin Lentze, Udhëheqës i ekipit të projektit "Mbështetje për Kodit Civil - Faza II" financuar nga BE" referuar si "Projekti"

për përcaktimin e dispozitave të mirëkuptimit në mes të Këshillit Gjyqësor dhe projektit në lidhje me punën praktike.

I. DEKLARATA E QËLLIMIT

A. Këshilli Gjyqësor e vlerëson fuqimisht dhe miraton partneritetin me Projektin e cili e avancon cilësinë e jetës dhe aspiratat qytetare, kulturore, arsimore, intelektuale të të diplomuarve të kualifikuar dhe të motivuar nga fakultetet juridike në mbarë vendin. Këshilli Gjyqësor e nxit vendosjen e praktikantëve në mjedise të caktuara si një pjesë e çmuar e procesit arsimor të të diplomuarve që do t'ju ofrojë atyre së paku një (1) vit përvojë në çështjet juridike nëpër gjykata apo zyrë juridike dhe të drejtën për të hyrë dhe për t'ju nënshtrohen Provimit të Jurisprudencës në përputhje me dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 pika 1.3. të Ligjit Nr. 04/L-141 për provimin e jurisprudencës.

B. Projekti ofron ekspertizë dhe mbështetje financiare për ngritjen e kapaciteteve të reja profesionale të sistemit juridik dhe gjyqësor të Kosovës në zbatimin e drejtë të dispozitave të Kodit Civil nëpërmjet inkurajimit të të diplomuarve (të diplomuar në një nga fakultetet juridike në bazë të programit katër (4) vjeçar ose që kanë përfunduar studimet master në lidhje me çështjet civile në Kosovë) Fakulteteve Juridike në Kosovë:
   - të jenë të përgatitur, të trajnuar dhe të pajisur me njohuri praktike për ushtrimin e pavarur të profesionit;
   - të zhvillojnë dhe të përmirësojnë kualifikimin e tyre profesional në çështjet e së Drejtës civile;

- të fitojnë njohuri dhe aftësi në aspektet organizative dhe funksionale të punës së përditshme brenda sistemit gjyqësor.

C. Këshilli Gjyqësor dhe Projekti e njohin mundësinë për përvoja pozitive të të mësuarit dhe përfitim reciprok për secilin, dhe për të diplomuarit e përzgjedhur për Punë praktike.

II. PËRGJEGJËSITË E NDËRSJELLA

A. Këshilli Gjyqësor do të:

- konsiderojnë të diplomuarit/aplikantët e përzgjedhur nga Komisioni Përzgjedhës I Projektit, si të pranueshëm për Punë praktike në përputhje me rregullat e përcaktuara, për një (1) vit të Punës praktike brenda strukturës organizative të sistemit juridik /gjyqësor;
- marrë përgjegjësinë për koordinimin e aktiviteteve të Punës praktike;
- nënshkruajë një Marrëveshje për Punë praktike me Praktikantët e përzgjedhur;
- caktojë një mbikëqyrës/mentor dhe një të emëruar të tij/saj i cili do të sigurojë orientimin specifik dhe trajnimet e nevojshme për Praktikantët, duke ua përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e tyre në vendet e tyre të punës apo ofrimin e shërbimit për Projektin;
- caktojë Praktikantët nëpër lokacione të caktuara të punës/ gjykata dhe të sigurojë se ata gjithmonë punojnë nën mbikëqyrjen e mbikëqyrësit/mentorit. Tu sigurojë Praktikantëve të gjitha resurset dhe mbështetjen e nevojshme për të përmbushur rolin e caktuar për punë efektive dhe efikase. Resurset e tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: hapësirë për zyre, qasje në kompjuter dhe baza të të dhënave përkatëse, materialet e zyrës të nevojshme për të kompletuar detyrat e caktuara të punës, mundësi për trajnime në vendin e punës dhe mundësi për zhvill profesional të cilat janë në dispozicion për Praktikantët;
- punojë ngushtë/të koordinohet me Projektin për të përmbushur pritjet dhe prioritetet e Projektit dhe do të shërbejë si ndërlidhje në mes Praktikantëve dhe Projektit;
- ofrojë dëshmitë e nevojshme për përfundimin me sukses të një (1) viti të Punës praktike e cila do t'u shërbejë si dëshmi e nevojshme për t'ju nënshtruar Provimit të Jurisprudencës.

B. PROJEKTI do të:

- mbështesë Këshillin Gjyqësor me Punë praktike për periudhën prej një (1) viti nga data 1 shkurt 2020 deri në 31 janar 2021 (12 muaj) bazuar në aktivitetet e parapara tek Komponenta B: Ngritja e kapaciteteve dhe të vetëdijesimit lidhur me Kodin Civil që rrjedhin nga Kontrata për Shërbime të Asistencës Teknike N ° 2016/383-059, për të pasuruar njohuritë dhe aftësitë e burimeve njerëzore për zbatimin e Kodit Civil dhe procesin e monitorimit dhe për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të kapaciteteve njerëzore;

- jetë përgjegjëse për procesin e përzgjedhjes së të diplomuarve/aplikantëve për të siguruar që kandidatët e përzgjedhur I plotësojnë kriteret për Punë praktike sipas rregullave të përcaktuara;
- financojë pagesën mujore të Praktikantëve për të gjithë periudhën e Punës praktike siç është rënë dakord me Praktikantët;
- ju ofrojë Praktikantëve mundësinë e informimit me kohë dhe pjesëmarrjes në të gjitha ngjarjet (takime, tryeza të rrumbullakëta, konferenca, diskutimet publike) të organizuara nga Projekti dhe që janë me rëndësi për e aktiviteteve e tij/saj të hulumtimit;
- sigurojë asistencë tjetër teknike dhe materiale për qëllim të një realizimi adekuat të programit për Punë praktike.

Në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me një mbikëqyrës/mentor të caktuar nga Përfituesi, Projekti do të monitorojë vijimin e praktikantëve në Punë praktike dhe si ai/ajo i përmbush obligimet e tij/saj sipas një marrëveshje për Punë praktike të nënshkruar në mes të Këshillit Gjyqësor dhe Praktikantit/Praktikantëve.

III VENDI I PUNËS SË PRAKTIKANTIT/PRAKTIKANTËVE

Duke pasur parasysh dispozitat e Nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3. të Ligjit Nr. 04 / L-141 për Provimin e jurisprudencës që parasheh si parakusht të paktën një (1) vit përvojë pune në çështjet ligjore në gjykatë, prokurori publike ose zyre juridike për të fituar të drejtën të hyjnë dhe i nënshtrohen Provimit të jurisprudencës, Praktikanti/Praktikantët gjatë periudhës së Punës praktike do të jenë të vendosur nga Këshilli Gjyqësor në disa nga gjykatat.

IV NDËRPRERJA E MARRËVESHJES PËR PUNË PRAKTIKE

Praktikanti duhet ti kryejë detyrat e tij/saj me integritet, respekt dhe besnikëri. Praktikanti do ti respektojë rregullat dhe procedurat e Këshillit Gjyqësor, duke përfshirë rregullat për konfidencialitetit. Nëse sjellja apo performanca e Praktikantit rezulton të jetë e pamjaftueshme, Këshilli Gjyqësor ka të drejtë që me shkrim, pa paralajmërim, dhe pas dëgjimit të Praktikantit të ndërpresë Marrëveshjen për Punë praktike të nënshkruar me Praktikantin.

Në rastin e ndërprerjes së Marrëveshjes për Punë praktike me Praktikantin, Këshilli Gjyqësor është i obliguar ta njoftojë Projektin brenda jo më shumë se tre ditësh pas ndërprerjes së Marrëveshjes.

V PËRFUNDIMI I KËTIJ MEMORANDUMI

Memorandumi i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të tij nga të gjitha palët dhe do të jetë në fuqi deri më 31 Janar 2021 përkatësisht përfundimin e një Punës praktike njëvjeçare.

Mbështetje për Kodin Civil

REPUBLIKA E KOSOVËS
PUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Për projektin	**Për përfituesin:**
Udhëheqësi i ekipit	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor
Z. Alfons Benjamin Lentze	Z. Skender Çoçaj
Nënshkrimi	*Nënshkrimi*
Datë 20-1-2020	*Datë* 28.01.2020

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA